

TREGTIA ME PAKICË

T2 - 2026

Indeksi i volumit të shitjeve në tregtinë me pakicë, i llogaritur bazuar në deflatimin e indeksit të shitjeve në vlerë, arriti 125,0 duke shënuar një rritje 6,8 %, krahasuar me tremujorin e dytë 2025. Ky tregues i përshtatur sezonalisht është rritur 1,6 %, krahasuar me tremujorin paraardhës.

Ndryshimi vjetor në indeksin e volumit të shitjeve në tregtinë me pakicë

- Në tregtinë me pakicë, pa përfshirë tregtinë me pakicë të hidrokarbureve, volumi i shitjeve në tremujorin e dytë 2026 është rritur me 6,3 %, kundrejt tremujorit të dytë të vitit 2025.
- Në grupin "Tregti hidrokarbure në njësi tregtare të specializuara", volumi i shitjeve është rritur me 8,4 %, krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit 2025.


Ndryshimi tremujor në indeksin e volumit të shitjeve në tregtinë me pakicë, i përshtatur sezonalisht

- Grupi "Tregti me pakicë, pa përfshirë tregtinë me pakicë të hidrokarbureve në njësi tregtare të specializuara", është rritur me 1,3 %, krahasuar me tremujorin paraardhës, përshtatur sezonalisht.
- Në grupin "Tregti me pakicë hidrokarbure në njësi tregtare të specializuara", volumi i shitjeve, i përshtatur sezonalisht është rritur me 2,1 %, kundrejt tremujorit të mëparshëm.

Ndikimi i grupeve në tregtinë me pakicë

- "Ushqime, pije e duhan në njësi tregtare jo të specializuara dhe të specializuara" ka kontribuar me +2,0 pikë përqindje.
- "Tregti me pakicë e hidrokarbureve në njësi tregtare të specializuara" me +2,1 pikë përqindje.
- "Artikuj jo-ushqimorë në njësi tregtare të specializuara dhe jo të specializuara" me +2,7 pikë përqindje.

FIG. 1 INDEKSI I VOLUMIT TË SHITJEVE NË TREGTINË ME PAKICË



TAB. 1 NDRYSHIMI VJETOR I INDEKSIT TË SHITJEVE NETO NË TREGTINË ME PAKICË DHE TREGTINË ME PAKICË TË HIDROKARBUREVE (PAPËRSHTATUR SEZONALISHT)

%

NVE Rev. 2	Aktiviteti Ekonomik	II.25-II.24	III.25-III.24	IV.25-IV.24	I.26-I.25	II.26-II.25
47	Tregti me Pakicë	6,2	6,0	6,2	6,7	6,8
47 pa 473	Tregti me Pakicë (Pa përfshirë Tregtinë me pakicë të hidrokarbureve në njësi tregtare të specializuara)	4,9	5,2	5,7	6,5	6,3
4711;472	Ushqime, pije e duhan në njësi tregtare jo të specializuara dhe të specializuara	4,6	5,4	5,3	6,3	6,0
4719; 474-478	Artikuj jo-ushqimorë në njësi tregtare të specializuara dhe jo të specializuara	5,1	5,0	6,0	6,6	6,4
473	Tregti me pakicë e hidrokarbureve në njësi tregtare të specializuara	10,1	8,6	7,2	7,5	8,4

TAB. 2 NDRYSHIMI TREMUJOR I INDEKSIT TË SHITJEVE NETO NË TREGTINË ME PAKICË DHE TREGTINË ME PAKICË TË HIDROKARBUREVE (PËRSHTATUR SEZONALISHT)

%

NVE Rev. 2	Aktiviteti Ekonomik	II.25 /I.25	III.25 /II.25	IV.25 /III.25	I.26 /IV.25	II.26 /I.26
47	Tregti me Pakicë	1,2	1,4	1,5	1,4	1,6
47 pa 473	Tregti me Pakicë (Pa përfshirë Tregtinë me pakicë të hidrokarbureve në njësi tregtare të specializuara)	1,1	1,3	1,6	1,1	1,3
4711;472	Ushqime, pije e duhan në njësi tregtare jo të specializuara dhe të specializuara	1,6	1,8	0,9	1,2	0,4
4719; 474-478	Artikuj jo-ushqimorë në njësi tregtare të specializuara dhe jo të specializuara	0,7	0,4	2,3	1,1	1,9
473	Tregti me pakicë e hidrokarbureve në njësi tregtare të specializuara	1,9	3,4	1,1	1,7	2,1

Shënim për përdoruesit:

- Të dhënat e detajuara janë të disponueshme në databazën statistikore të INSTAT: [Tregtia me pakicë](#)
- Në zbatim të Politikës së Trajtimit të Gabimeve, INSTAT ndërmerr pa vonesë korrigjimin e çdo gabimi të identifikuar në statistikat zyrtare të publikuara. Përdoruesit informohen në mënyrë të menjëhershme dhe transparente për korrigjimet dhe ndryshimet e reflektuara, në përputhje me parimet e paanshmërisë, transparencës dhe cilësisë së statistikave zyrtare. Politika e plotë e Trajtimit të Gabimeve është e disponueshme në adresën: <https://www.instat.gov.al/media/9577/politika-e-trajtimite-gabimeve.pdf>

Metodologjia

Informacion mbi vrojtimin

Qëllimi - Statistikat tremujore të Tregtisë me pakicë pranë ndërmarrjeve përshkruajnë ecurinë dhe zhvillimet më të fundit të treguesve ekonomik në njësitë e shitjes me pakicë dhe konsumit të popullatës në vend.

Baza ligjore të cilës i nënshtrohet metodologjia e prodhimit të treguesve të Tregtisë me Pakicë, është Rregullorja (BE) 2019/2152 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 27 nëntor 2019 për Statistikat Evropiane të Biznesit.

Fusha e mbulimit - Bazuar në aktivitetin kryesor janë përfshirë në vrojtim:

- ndërmarrjet e tregtisë me pakicë grupi 47-NVE Rev.2 (përfshito 4779-4799);

Modeli - Kampioni i ndërmarrjeve është zgjedhur nga Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve, ku:

Kampioni për ndërmarrjet me 1 - 4 të punësuar është marrë me zgjedhje, ndërsa ndërmarrjet me 5 e më shumë të punësuar janë anketuar tërësisht.

Mbledhja e informacionit - Për këtë tremujor është përdorur burimi administrativ dhe intervistim të drejtpërdrejtë të ndërmarrjeve nga anketuesit.

Treguesit - Janë dhënë në formë indeksi, ndryshimi tremujor në përqindje, ndryshimi vjetor në përqindje me një vit referues bazë, aktualisht 2021=100. Të dhënat nuk paraqesin vlera absolute.

Indekset - Shprehin ndryshimin në kohë të një variabli të dhënë ose tërësi variablash. Indeksi i volumit është llogaritur me anë të formulës Laspeyres. Për të eliminuar ndikimin e çmimeve, indekset deflatohen me indeksin e çmimeve të konsumit për periudhat përkatëse sipas grupeve përkuese.

Ndryshimi vjetor në përqindje - Mat ndryshimin në përqindje të treguesit ekonomik të tremujorit aktual ndaj tremujorit të njëjtë të një viti më parë.

Ndryshimi tremujor në përqindje - Mat ndryshimin në përqindje të treguesit ekonomik të tremujorit aktual ndaj tremujorit paraardhës.

Rishikimi – Indekset mund të rishikohen për disa arsye: Informacion shtesë, ndryshime metodologjike ose rivlerësime të koeficientëve të përdorur, etj.

Përkufizim i treguesit kryesor - Shifra e afarizmit përfshin shitjet mujore gjithsej që ndërmarrja realizon gjatë muajit nga shitja e produkteve apo shërbimeve përjashtuar Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (TVSH).

Përshtatja sezonale dhe kalendarike

Përshtatja sezonale dhe kalendarike në seritë mujore / tremujore të Tregtisë me pakicë u zbatua duke përdorur si software JDemetra+, versioni 2.2.4. Model i përzgjedhur për shpërbërjen e serive është X-12 Arima, nënspecifikimin X-13 në serinë kohore Tremujori I 2005 - Tremujori II 2026. Modeli X-12 Arima bazohet plotësisht mbi mesataren e lëvizshme. Në serinë e të dhënave është zbatuar shpërbërja e shumëfishtë (multiplikative).